



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 73 Datë 15.10.2007

PËR

RRITJE LIMITI PËR PËRDORIM TË ARDHURASH TË
NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, “ PËR RRITJE LIMITI PËR PËRDORIM TË ARDHURASH TË NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE”, bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32 pika “dh”, ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 “Për buxhetin lokal”, Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”. Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007”. Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme “Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007”, si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007” mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e limitit nga të ardhurat e dyta të institucionit të N.Sh.P. në vlerën 400.000 lekë dhe përdorimin në zërin e shpenzimeve “mbushje gropë” sipas lejes së dhënë nga N.Sh.P. me këtë strukturë buxhetore:

Shtohet	00	06260	05	Art 6020000	M/Shtator 2007 + 400.000 lekë
---------	----	-------	----	-------------	----------------------------------

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës në Bashki dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE